

VENDIM
Nr. 583, datë 6.10.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE MËNYRAVE TË ADMINISTRIMIT
TË BAZËS SË TË DHËNAVE TË PASURIVE KULTURORE TË VJEDHURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 130, të ligjit nr. 7/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton dhe shtrin fushën e veprimit, në:

a) përcaktimin e procedurave dhe mënyrave të administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të dala në mënyrë të paligjshme në ose nga territori i Republikës së Shqipërisë (në vijim “Baza e të dhënave”);

b) mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave në lidhje me të gjitha pasuritë kulturore, të parashikuara në nenet 50 e 51, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të cilat:

i. raportohen si të vjedhura ose të humbura nga pronari ose poseduesi legjitim i pasurisë kulturore; ose

ii. janë gjetur nga autoritetet përkatëse ligjzbatuese duke u importuar, eksportuar dhe/ose trafikuar në mënyrë të paligjshme në ose nga territori i Republikës së Shqipërisë.

2. Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Administrimi i bazës së të dhënave”, menaxhimi nga autoriteti publik i bazës së të dhënave, që përfshin të gjitha llojet e aksesit në sistemin e bazës së të dhënave, përfshirë përditësimin dhe ndryshimin e informacionit të ruajtur;

b) “Autoriteti rregullator koordinues i bazave së të dhënave shtetërore”, është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;

c) “Baza e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura”, mbledhja e organizuar e informacionit lidhur me pasuritë kulturore të vjedhura, të hyra ose të dala në mënyrë të paligjshme në ose nga territori i Republikës së Shqipërisë, të ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhen nëpërmjet një sistemi kompjuterik, sipas rregullave të parashikuara në nenin 130, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, dhe legjislacionit të zbatueshëm në fuqi;

ç) “Institucioni administrues”, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK), që është përgjegjës për administrimin e bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura;

d) “Ndërveprim”, procesi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet bazave të të dhënave shtetërore;

dh) “Ofruesi i informacionit”, subjektet publike ose private, siç përcaktohet në këtë vendim, që sigurojnë informacione për plotësimin e bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura;

e) “Palë e interesuar”, çdo person fizik ose person juridik i cili lejohet të ketë akses të drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave, sipas përcaktimeve në këtë vendim.

II. PROCEDURA E DHËNIES SË INFORMACIONIT

3. Dhënësit e informacionit e sigurojnë informacionin nëpërmjet një deklarate, sipas modelit “A” dhe “B”, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Në rolin e dhënësit të informacionit janë:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

b) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

c) njësitë e vetëqeverisjes vendore;

ç) institucionet publike kombëtare që kanë në pronësi dhe administrojnë fonde të pasurive kulturore;

d) organizmat ndërkombëtarë që operojnë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë dhe që kanë në fushën e veprimtarisë së tyre edhe trashëgimisë kulturore;

dh) bashkësitë fetare.

III. TË DHËNAT PARËSORE DHE DYTËSORE TË BAZËS SË TË DHËNAVE TË PASURIVE KULTURORE TË VJEDHURA

5. “Të dhënat parësore” janë të dhënat e mbledhura nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore dhe të përditësuara në bazën e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura “Pasuritë kulturore të vjedhura”.

6. “Të dhënat dytësore” janë të dhënat që merren nga:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe përfshijnë:

Të dhënat e ngjarjes

i. kodi i ngjarjes/ numër reference;

ii. zyra e cila ka marrë raportin e ngjarjes ose e raporton atë;

iii. protokollin e zyrës proceduese;

iv. referenca e bazës së të dhënave;

v. data e aktit;

vi. data e ngjarjes;

vii. ankuesi;

viii. vendi ku është kryer krimi;

ix. qarku;

x. bashkia;

xi. njësia administrative;

xii. adresa;

xiii. përshkrimi i ngjarjes;

xiv. skeduesi;

xv. data e skedimit.

b) Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (për objektet që janë të regjistruara në RKPK) dhe përfshijnë:

Të dhëna mbi objektin

i. kodi i objektit;

ii. lloji i objektit;

iii. teknika;

iv. materiali;

v. gjatësia;

vi. gjerësia;

vii. lartësia;

viii. diametri;

ix. pesha;

x. vlera;

xi. periudha;

xii. titulli;

xiii. autori;

xiv. numri i inventarit;

xv. kodi RKPK.

Galeria e objektit

i. dokumentacioni administrativ (urdhra, vendime);

ii. dokumentacioni fotografik për objektet;

iii. dokumentacioni audiovizual për objektet e trashëgimisë materiale ose jomateriale;

iv. emërtimi;

- v. madhësia;
- vi. lloji;
- vii. pamja ballore.

Statusi

- i. status autenciteti;
- ii. i humbur;
- iii. status dëmtimi;
- iv. trashëgimi;
- v. aprovuar;
- vi. miratuar;

Historiku

- i. titulli;
- ii. historiku;
- iii. bibliografia.

Përshkrime

- i. akademik;
- ii. përshkrimi;
- iii. të tjera.

c) Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile nën administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

ç) Regjistri Tregtar nën Administrimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit: **NIPT, emërtimi, administratori, adresa, statusi (aktiv, pezulluar, çregjistruar).**

7. Të dhënat, që vendosen në dispozicion nga Policia e Shtetit, miratohen paraprakisht nga prokurori i çështjes.

IV. ADMINISTRIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE

8. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore përfaqëson autoritetin e vetëm, i cili përcakton të drejtat dhe kufizimet e operimit në bazën e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, përmes Sistemit Informatik Kombëtar të Regjistrimit dhe Administrimit të Pasurive Kulturore, nëpërmjet kërkesave të skemave të aksesit me nivele të shkallëzuara dhe hierarkike të administrimit të informacionit respektiv për të gjithë punonjësit.

9. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, si institucion administrues i bazës së të dhënave, pas kryerjes dhe bazuar në rezultatet e analizës së sigurisë, përcakton grupet dhe nëngrupet e sigurisë të të dhënave, siç parashikohet në dispozitat e kapitullit V, të vendimit nr. 945, datë 2.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore’”, të ndryshuar.

10. Palët e interesuara në bazën e të dhënave janë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si dhe institucionet e tyre të varësisë.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si dhe institucionet e tyre të varësisë kanë akses të plotë në bazën e të dhënave me të drejta vetëm për shikim (*viewer*) të të dhënave.

12. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore është përgjegjësi kryesor për përpunimin e të dhënave. Të dhënat personale të përfshira në bazën e të dhënave përpunohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9887/2008. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore mbikëqyr funksionimin e duhur të bazës së të dhënave dhe pajtueshmërinë me dispozitat që rregullojnë metodat dhe kushtet e komunikimit të të dhënave.

13. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore mund të shpërndajë të dhënat për qëllime statistikore dhe në formë të përpunuar për qëllime të studimeve dhe parandalimit të krimeve, me anë të teknikave që nuk lejojnë identifikimin e palëve të interesuara, qoftë edhe tërthorazi.

14. Institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore mund të kërkojnë informacionin që ruhet në bazën e të dhënave nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore të kufizuar te të dhënat jopersonale.

15. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, duke marrë parasysh qëllimet e përmendura në pikat 13 e 14, të këtij vendimi, përdor bazën e të dhënave edhe për përpunimin e statistikave, kërkimeve, studimeve e analizave të të dhënave, si dhe për komunikimin ose shpërndarjen e mundshme të tyre, vetëm në formë anonime, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

V. AKSESI I PUBLIKUT NË BAZËN E TË DHËNAVE

16. Personat fizikë ose juridikë privatë mund të kenë qasje të tërthortë në bazën e të dhënave përmes kërkesave në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, në përputhje me shtojcën “C”.

17. Tregtarët e pasurive kulturore dhe qytetarët kanë të drejtë të kërkojnë verifikimin e prejardhjes legjitime të një pasurie kulturore në bazën e të dhënave, duke dërguar një kërkesë zyrtare me shkrim tek Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, sipas pikës 16, të këtij vendimi, me kusht që të paraqesin informacionin e nevojshëm për identifikimin e objektit të kërkesës dhe vendndodhjen e saktë të tij.

18. Mënyra e aksesimit në sistem të subjekteve të interesuara bëhet sipas skemës së mëposhtme:

Subjekti i interesuar	Përshkrimi i procesit
1. Institucionet që posedojnë dhe administrojnë fonde të pasurive kulturore	Konsultues (<i>Viewer</i>) i informacionit nëpërmjet WEB-it
2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	Konsultues (<i>Viewer</i>) i informacionit nëpërmjet WEB-it
3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Konsultues (<i>Viewer</i>) i informacionit nëpërmjet WEB-it.
4. Personat fizikë/juridikë	Konsultues (<i>Viewer</i>) i informacionit nëpërmjet WEB-it
5. Bashkësitë fetare	Konsultues (<i>Viewer</i>) i informacionit nëpërmjet WEB-it
6. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore	Administrator dhe editor

19. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore është përgjegjës për menaxhimin në përputhje me këtë vendim të aksesit në bazën e të dhënave. Në rast të gjetjes së veprimeve të paligjshme do të pezullojë menjëherë qasjen e personit i cili ka vepruar në kundërshtim me ligjin, udhëzimet dhe procedurat për administrimin e bazës të të dhënave. Pezullimi i aksesit nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore, civile ose penale.

VI. DISPOZITAT E FUNDIT

20. Ngarkohen ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

MINISTRIA E KULTURËS

Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore

- GRAFIKU I NGJARJEVE -

SEKSIONI A - TË DHËNAT E NGJARJES

1	() Zyra e cila ka marrë raportin e ngjarjes ose e raporton atë (vulosur):
2	Protokolli i Bazës së të Dhënave të Policisë:
3	Protokolli i zyrës proceduese:
4	Referenca e bazës së të dhënave (nëse dihet) ¹ :
5	Data e ankesës:
6	Data e ngjarjes:
7	Ankuesi ² :
8	Lloji i krimit të kallëzuar (neni):
9	Vendi ku është kryer krimi:
	a) Lloji i vendit ³ :
	b) Emri ⁴ :
	c) Qarku:
	d) Bashkia:
	e) Njësia administrative ⁵ :
	f) Adresa:
	Modus operandi ⁶ :

¹ E dobishme në rastin e një shtese ankese në lidhje me të njëjtin fakt

² Emri, Mbiemri, Data dhe Vendi i Lindjes, Adresa e banimit (e-maili dhe numri i telefonit), profesioni, veçanërisht nëse është e dobishme të konstatohet pronari i mallrave: d.m.th prifti, ose drejtori i muzeut / arkivit / bibliotekës, restauruesi privat, etj.

³ p.sh. kishë / abati / faltore, muze, shtëpi private, bibliotekë, arkiv, zonë arkeologjike

⁴ p.sh "Kisha e Shën Gjoni Pagëzuesit"

⁵ Nëse ka

⁶ Përshkrim i shkurtër i faktit

MINISTRIA E KULTURËS*Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore***- GRAFIKU I NGJARJEVE -****SEKSIONI B - PASURITË KULTURORE TË VJEDHURA****Nr.**

1	Protokolli i Bazës së të Dhënave të Policisë të ngjarjes në fjalë ¹ :
2	Protokolli i Zyrës Proceduese ² :
3	Përshkrimi teknik
	a) Lloji i Objektivit ³ :
	b) Teknikat ⁴ dhe materialet ⁵ :
	c) Formati ⁶ : <input type="checkbox"/> HORIZONTAL <input type="checkbox"/> VERTIKAL <input type="checkbox"/> RRETHOR <input type="checkbox"/> OVAL <input type="checkbox"/> TJETËR
	d) Matjet (cm): Lartësia.....; Baza.....; Thellësia.....; Diametri.....; Pesha (për skulptura, këmbana).....(Kg)
	e) Autori:
	f) Objekt i nënshkruar:
g) Titulli:	
4	Përshkrimi i lirë dhe çdo element tjetër i dobishëm për identifikimin e objektit
5	Vlerësimi ekonomik (vlera e tregut) ⁷ :
	Pasuri e siguruar: <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> PO Vlera e siguruar ⁸ :
6	Kodi i katalogut të IKRTK-së:
7	Riprodhimi fotografik i bashkangjitur: <input type="checkbox"/> PO <input type="checkbox"/> JO

¹ duhet të raportohet në rast të dërgimit ndarazi të formularëve Kartelat e Ngjarjeve – Seksionet A dhe B² duhet të raportohet në rast të dërgimit ndarazi të formularëve Kartelat e Ngjarjeve – Seksionet A dhe B³ P.sh. Piktura, skulpturë, libër antik, dorëshkrim, etj⁴ P.sh Çfarë teknike është përdorur (gdhendje, kallëp, gravurë, vaj, tempera, media të përziera, grafika, bojëra uji, litograf, etj)⁵ P.sh Çfarë lloj materiali është përdorur? (dru, kanavacë, ar, argjend, bronz, tunxh, mermër, etj.)⁶ Për HORIZONTAL ose VERTIKAL, zgjidhni formatin sipas anës më të gjatë të vepërës së artit⁷ Vendosi vlerën në Euro ose Lek⁸ Vendosi vlerën në Euro ose Lek

MINISTRIA E KULTURËS

Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore

- GRAFIKU I RIKUPERIMIT -

TË DHËNAT E RIKUPERIMIT

1	Drejtoria e Policisë ku është raportuar ngjarja (e vulosur):	
2	Data e rikuperimit:	
3	Vendi i rikuperimit:	
	a) Lloji i rikuperimit ¹	
	b) Qarku:	
	c) Bashkia:	
	d) “Njësitë Administrative (qytetet dhe/ose fshatrat)	
4	Sasia e përgjithshme e pasurive të rikuperuara:	
5	Personi i raportuar pranë Autoritetit Gjyqësor:	<input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> PO

TË DHËNA PËR VJEDHJEN OSE EKSPORTIN E PALIGJSHËM²

1	Drejtoria e Policisë ku është raportuar vjedhja ose Zyra e Eksportit ku është lëshuar /mohuar certifikata e licencës së qarkullimit të lirë
2	Data e ankesës:
3	Kallëzimi për vjedhje
4	Ankuesi:
5	Protokolli i Bazës së të Dhënave të Policisë ³ :

¹Shtëpi, ambient i hapur (rrugë, tokë), dyqan i mallrave antike, galeri arti, etj.

²Të plotësohet në rast të rikuperimit të pasurive të vjedhura ose të eksportuara në mënyrë të paligjshme

³Ky numër protokolli i referohet Bazës së të Dhënave të përdorur nga Policia e Shtetit.

MINISTRIA E KULTURËS

Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore

GRAFIKU I RIKUPERIMIT

MALLI KULTUROR I RIKUPERUAR

1	Përshkrimi teknik
	a) Lloji i Objektivit ⁴ :
	b) Teknikat ⁵ dhe Materialet ⁶ :
	c) Formati ⁷ : <input type="checkbox"/> HORIZONTAL <input type="checkbox"/> VERTIKAL <input type="checkbox"/> RRETHOR <input type="checkbox"/> OVAL <input type="checkbox"/> TJETËR
	d) Matjet (cm): Lartësia.....; Baza.....; Thellësia.....; Diametri....; Pesha (për skulptura, këmbana).....(kg)
	e) Autori:
	f) Objekt i nënshkruar:
	g) Titulli:
2	Përshkrim i lirë dhe çdo element tjetër i dobishëm për identifikimin e objektit ⁸
3	Vlerësimi ekonomik (vlera e tregut) ⁹ :
	Pasuri e Siguruar: <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> PO Vlera e siguruar ¹⁰ :
4	Kodi i katalogut të IKRTK-së:
5	Riprodhimi fotografik i bashkangjitur ¹¹ :

⁴ P.sh. Piktura, skulpturë, libër antik, dorëshkrim, etj

⁵ P.sh Çfarë teknike është përdorur (gdhendje, kallëp, gravurë, vaj, tempera, media të përziera, grafika, bojëra uji, litograf, etj)

⁶ P.sh Çfarë lloj materiali është përdorur? (dru, kanavacë, ar, argjend, bronz, tunxh, mermer, etj.)

⁷ Për HORIZONTAL ose VERTIKAL, zgjidhni formatin sipas anës më të gjatë të veprës së artit

⁸ Vendorsni informata mbi çdo dëmtim i veprës së artit, restaurim, etj

⁹ Vendorsni vlerën në Euro ose Lek

¹⁰ Vendorsni vlerën në Euro ose Lek

¹¹ Fotografitë e rikuperimit: një fotografi për secilën pasuri kulturore të rikuperuar

MINISTRIA E KULTURËS

Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore

FORMULARI I KËRKESËS PËR VERIFIKIM PRIVAT¹

Unë, i nënshkruari² _____

Banor i _____, rruga _____, nr. _____

tel./faks _____, e-mail: _____

Dokumenti identifikues (kopja e bashkëngjitur) _____

Kërkoj³ _____

verifikimin nëse veprat⁴ e renditura përputhen me pasuritë e renditura në Bazën e të Dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të menaxhuar nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK):

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

Bashkëngjitur janë imazhet e veprave të lartë përmendura, aktualisht të disponueshme në

_____, të ndodhura në _____ më _____

Vendi

Nënshkrimi

N.B.

Informacioni në lidhje me identitetin e kërkuesit, vendndodhjen e mallit, arsyen e kërkesës dhe përpilimin e plotë të kërkesës janë thelbësore për trajtimin e saj.

Në rast të paraqitjes në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore,

Nënshkrimi i Zyrtarit Pranues

¹Gjithashtu mund të dërgohen me postë elektronike ose me postë elektronike të certifikuar tek Ministria së Kulturës - IKRTK, një ankesë e shoqëruar me një kopje të një dokumenti identifikimi, ose paraqitur direkt me shkrim;

²Emri, mbiemri, data dhe vendi i lindjes, adresa e paraqitësit të kërkesës;

³Arsyeja e kërkesës (blerje, shitje, studim, restaurim, etj);

⁴Autori, titulli, teknika e ekzekutimit, matjet dhe çdo shënim tjetër përshkrues.